

**DR. EDUART CAKA**

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë  
edicaka@hotmail.com

**FIZIONOMIA E NJË QYTETI: HAPËSIRA URBANE DHE  
LAGJET E ELBASANIT GJATË SHEK. XVI-XVII\*****Abstrakt:**

*Në këtë artikull synojmë të paraqesim panoramën zhvillimore që pësoi qyteti i Elbasanit gjatë shek. XVI-XVII, duke u ndalur në dy parametra kryesorë: atë demografik dhe infrastrukturor me qëllim që në këtë mënyrë të realizojmë një përfytyrim urbanistik të njërit prej qyteteve më të mëdha shqiptare të periudhës osmane. Më konkretisht, shkrimi konsiston në trajtimin e faktorëve që ndikuan në rritjen ekonomike, demografike, kulturore e politike të kësaj qendre të rëndësishme demografike, duke u përqendruar veçanërisht te zgjerimi urbanistik që ajo pësoi prej rithemelimit të kalasë, daljes së lagjeve përtej mureve rrethuese dhe elementeve të tjera që ndikuan në formësimin e peizazhit urbanistik për një periudhë thuhetse dyshekullore.*

**Fjalë kyç:**

*Elbasan, periudha osmane, arkitekturë, hapësirë urbane, lagje.*

**Hyrje**

Burimet e kohës – më saktësisht kronikat bizantine dhe ato osmane, si edhe dokumentacioni përëndimor, përfshirë ato veneciane, përputhen me njëra-tjetrën në faktin se kalaja e Elbasanit u ringrit nga sulltani osman mbi themelet ekzistuese. Sipas këtyre burimeve, vetë Mehmedi II qëndroi personalisht në krye të punimeve, duke mbikëqyrur mbarëvajtjen

---

\* Ky studim është mundësuar me mbështetjen financiare të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit, opinioni i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i AKKSHI-t.

e tyre për t'u siguruar që ndërtimet të mbaronin sa më shpejt.<sup>1</sup> Më pas janë burimet osmane, përkatësisht regjistrat kadastrorë – të njohur ndryshe edhe si *Tahrir Defterleri*, ato që na informojnë saktësisht për banorët e parë që u vendosën në këtë qytet-kala, i cili do të emërtohej *Ilbasan*.<sup>2</sup> Pikërisht me këtë ndërtim merr pikënisjen edhe bërthama e njërit prej qyteteve më të zhvilluara shqiptare të periudhës osmane.

Historianët vendës dhe të huaj që kanë kryer studime mbi Elbasanin thuajse bashkohen njëzëri për përkufizimin e kësaj qendre urbane, duke e quajtur atë një qytet “tipik oriental”. Me këtë emërtim, ata i janë referuar si fizionomisë urbanistike që e karakterizon hapësirën në fjalë, ashtu edhe strukturës shoqërore që u zhvillua paralelisht me vendbanimin e ri.<sup>3</sup> Duke lënë mënjanë aspektet shoqërore, kulturore e demografike, në këtë

<sup>1</sup> Kronikat e kohës shprehen se punimet ishin kryer brenda një periudhe shumë të shkurtër, duke dhënë, madje, edhe afate kohore që arrinin deri në tridhjetë ditë. Për më shumë, shih Vexhi Buharaja, “Rreth mbishkrimeve të fortesës së Elbasanit”, *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. II (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1989), 515-517; *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë (shek. X-XV)*, përgatiti Koço Bozhori, Filip Liço (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1975), 348-349; Gjerak Karauskaj, *Pesë mijë vjet fortifikime në Shqipëri* (Tiranë: 8 Nëntori, 1980), 206. Për përshkrimin që i bëjnë kronistët osmanë punimeve të Mehmetit II për rindërtimin e Elbasanit, shih *Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV (Burime osmane)*, përgatitur për shtyp nga Selami Pulaha (Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë), 1968.

<sup>2</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Illirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet '20 të shek. XIX), redaktor shkencor Kristaq Prifti, grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: Toena, 2002), 452; Machiel Kiel, “Ilbasan”, *TDV Islam Ansiklopedisi*, C. XXII (Istanbul: TDV Yay., 2000), 79-81; Nikolai Todorov, *The Balkan City, 1400-1900* (Seattle: University of Washington Press, 1983), 62.

<sup>3</sup> Franz Babinger, *Aufsätze und Abhandlungen zur Geschichte Südosteuropas und der Levante*, v. I (München: Schmidt & Klaunig Kiel, 1962), 203; Dritan Egro, “Islam in Albanian Lands during the First Two Centuries of the Ottoman Rule”, *Ph.D Dissertation* (Ankara: University of Bilkent, 2003), 172; Eduart Caka, “The Making of a Bordering Town: The City of Elbasan during XV-XVI Centuries”, *Albanian Studies*, no. 2 (2023): 73-76. Një element të tillë e përmend edhe Kiel, kur i referohet fizionomisë së qytetit që u transformua gjatë gjysmës së dytë të shek. XX, duke theksuar: “E gjithë qendra e qytetit është rindërtuar, duke ruajtur vetëm disa monumente historike. Të gjitha, përveç dy xhamive, u shembën gjatë një përpjekjeje për të fshirë stampën myslimane të qytetit.” Për më shumë, shih Machiel Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri (1385-1912)*, përktheu Klodiana Smalajaj (Tiranë: AIITC, 2012), 140.

artikull do të mjaftohemi vetëm me trajtimin e elementeve arkitekturore dhe urbanistike që e karakterizuan Elbasanin gjatë dy shekujve të parë nën sundimin osman.

Fakti që bashkë me rindërtimin e kalasë fillon edhe zhvillimi urbanistik i Elbasanit, na vë përballë një problemi, siç është ai i vazhdimësisë së veprave arkitekturore apo i traditës në këtë këndvështrim.<sup>4</sup> Për ta shtjelluar më gjerë këtë aspekt, vlen të theksohet se në qytetet e ndërtuara në periudha të mëparshme – pra aty ku kishte ndërtesa ekzistuese – ngritja e objekteve të reja arkitekturore konsistonte kryesisht në përcaktimin e vendosjes së tyre hapësinore duke marrë parasysh objektet ekzistuese. E njëjta gjë vlen edhe për stilin arkitekturor të objekteve të reja që do të ngriheshin aty. Në këtë kontekst, për studiuesin paraqitet si domosdoshmëri shqyrtimi i procesit të planifikimit urban që pëson qyteti gjatë vendosjes së një sundimi të ri në raport me planimetrinë dhe stilin arkitekturor ekzistues. Mirëpo, në rastin e Elbasanit, një analizë e tillë është e panevojshme, pasi bërthama e qytetit ishte kalaja, brenda së cilës do të zhvilloheshin edhe lagjet e para të qytetit.

## Kalaja

Kalaja e Elbasanit u rindërtua nga Mehmedi II me synimin për të mbajtur në kontroll rrugët që lidhnin hapësirat veriore të tokave shqiptare dhe, veçanërisht, për t'i ushtruar presion Skënderbeut. Pas përfundimit të punimeve, sulltani la 400 trupa ushtarake brenda kalasë, të cilat kishin për detyrë të siguronin mbrojtjen e saj.<sup>5</sup> Së bashku me këta ushtarë, osmanët deportuan këtu edhe një numër familjesh nga hapësira të ndryshme të Shqipërisë dhe Ballkanit, duke shënuar kështu edhe ripopullimin e kalasë.

Për ta përshkruar fizikisht, mund të thuhet se kështjella në fjalë kishte një pamje drejtkëndore me përmasat 308m x 348m, me një

<sup>4</sup> Në lidhje me konceptin e trashëgimisë në arkitekturën dhe fizionominë urbanistike të qyteteve, shih Heghnar Zeitlian Watenpaugh, *The Image of an Ottoman City: Imperial Architecture and Urban Experience in Aleppo in the 16<sup>th</sup> and 17<sup>th</sup> Centuries* (Leiden: Brill, 2004), 2-3.

<sup>5</sup> *Arşiv Belgelerine Göre Osmanlı Kaleleri* (İstanbul: Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Osmanlı Arşivi Daire Başkanlığı, 2016), 78 (më tej: *Osmanlı Kaleleri*).

perimetër muri prej rreth 1 800 hapash.<sup>6</sup> Sipas Kiel-it ajo kishte 26 kulla, një mur 10.20 m të lartë (15 arshin), një hendek rreth 3 metra të gjerë që mbushej me ujën e Zaranikës, si dhe tri porta të mëdha prej hekuri, dykapakëshe, që shihnin nga drejtimi jugor, perëndimor dhe lindor.<sup>7</sup> Mbi portën që hapej drejt Jugut, aty ku më vonë do të vendosej edhe tregu, gjendej edhe mbishkrimi i kalasë së Elbasanit, i cili është tanimë i njohur prej kohësh.<sup>8</sup>

Pavarësisht përmasave të mëdha që karakterizojnë kalanë, duket se muri nuk ka qenë i një cilësie të mirë.<sup>9</sup> Kjo del në pah si nga fakti që punimet për ndërtimin e kështjellës u kryen brenda një periudhe shumë të shkurtër, ashtu edhe nga gurët e përdorur. Sipas Kiel-it, zbukurimet ose gurët e gdhendur në formë të mirë nuk janë vendosur në të gjithë strukturën, por vetëm në raste të caktuara.<sup>10</sup> Vetëm një shekull më vonë, përkatësisht më 1570, autorë të kohës i përshkruajnë muret e kështjellës

<sup>6</sup> Duhet theksuar se lidhur me shifrat mbi përmasat e kalasë, numrin e kullave, lartësinë e mureve, thellësinë e bedenave dhe elementet e tjera statistikore, ekzistojnë diferenca midis të dhënave të paraqitura nga studiuesit. Ata kryesisht bazohen në informacionet që jep Çelebiu, por i krahasojnë këto edhe me matjet dhe studimet që kanë kryer në terren. Kështu, Kiel i quan si të ekzagjeruara shifrat që jep kronisti osman mbi numrin e kullave, lartësinë e mureve dhe perimetrin e kështjellës. Kështu, Çelebiu shprehet se kalaja rreth e qark ishte plot 2 400 hapa, ndërsa Kiel shkruan se bëhej fjalë për 1 200 të tillë. Shih *Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, C. 8 (İstanbul: Orhaniye Matbbasi, 1928), 718; Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 141. Në fakt, shifra e dhënë nga udhëtari osman është e drejtë, por Kiel ngatërron faktin se një hap nuk është i barabartë me një metër dhe, duke u bazuar tek të dhënat e Çelebiut në lidhje me zërat e tjerë, shprehet: “Më duket se Evlia Çelebiu i ka dyfishuar të gjitha përmasat dhe numrat, në mënyrë që ta bënte kalanë e sulltanit më madhështore sasa ishte në të vërtetë...”. *Po aty*, 141. Në të vërtetë, sa i përket perimetrin, duhet theksuar se *hapi* si njësi matëse tek osmanët, përfshirë këtu edhe periudhën e Çelebiut, që i përket shek. XVII, konvertohej në 75.8 centimetra. Kjo na çon në përfundimin se perimetri i vërtetë i kështjellës ishte afërsisht rreth 1 800 hapa. Për konvertimin e hapit tek osmanët, shih Sargon Erdem, “Ayak”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. IV (İstanbul: TDV Yay, 1991), 191.

<sup>7</sup> Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 141. Çelebiu flet për 50 kulla si dhe porta dykatëshe. Shih *Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, 718. Në këtë pikë, Kiel e ka keqinterpretuar Çelebiun, duke i shënuar portat dykatëshe si dy kapakëshe.

<sup>8</sup> Për mbishkrimin e kalasë së Elbasanit dhe leximin që i kanë bërë asaj si Babinger, ashtu edhe Buharaja, shih: Buharaja, *Rreth mbishkrimeve të fortesës së Elbasanit*, 503-514.

<sup>9</sup> Për një përshkrim të detajuar të mënyrës së ndërtimit dhe aspekteve teknike, si përmasat e kalasë, shih: Karaiskaj, *Pesë mijë vjet fortifikime*, 206-207.

<sup>10</sup> Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 140.

së Elbasanit si të mëdha, por të dobëta.<sup>11</sup> Ndoshta, një nga arsyet e neglizhencës së osmanëve për meremetimin dhe mirëmbajtjen e saj gjatë shekujve të mëvonshëm lidhet me faktin se kështjella e kishte humbur tanimë rolin e saj parësor që ishte ai ushtarak, ndërsa kalaja ishte bërë pjesë përbërëse e qytetit të Elbasanit.

Fakti që arsyeja kryesore e rindërtimit të kështjellës ishte karakteri i saj ushtarak dhe strategjik, vërehet si në tipologjinë, ashtu edhe në toponiminë e ambienteve brenda hapësirës së saj. Për shembull, njëra prej portave të kalasë, ajo në anën perëndimore, njihej si *Porta e Jeniçerëve* (Jeniçeriler Kapisi),<sup>12</sup> duke iu referuar kështu pjesës më të zgjedhur të ushtrisë osmane. Po ashtu, duhet pasur parasysh edhe prania e një numri të caktuar nëpunësish ushtarakë që kishin për detyrë mbrojtjen e saj, si edhe ruajtjen e rendit, për të cilët ishin ndërtuar kazermat, depot dhe ambiente të tjera të nevojshme.<sup>13</sup>

Gjatë vizitës së tij në qytet më 1670, Evlija Çelebiu bëri vëzhgime interesante jo vetëm mbi fizionominë e kalasë dhe objektet arkitekturore që ndodheshin aty, por edhe mbi elemente të tjera që lidheshin me pamjen fizike të kështjellës, mbishkrimet që pa, si dhe veçoritë e banorëve që jetonin brenda mureve të saj. Sipas kronistit osman brenda kalasë gjendeshin plot 460 shtëpi, të cilat, ndonëse nuk kishin kopshte e bahçe, ishin të gjera si ndërtesa dhe disa prej tyre edhe dykatëshe.<sup>14</sup>

Sikurse del në pah edhe nga informacioni burimor, krahas ndryshimeve që kanë ardhur si rrjedhojë e rritjes demografike të qytetit dhe zgjerimit të lagjeve të reja, në transformimin urban të kalasë kanë

<sup>11</sup> Sime Ljubić, “İzvjestaj god. 1570 o Arbanaskoj”, *Starine*, XII (Zagreb: Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, 1880), 198.

<sup>12</sup> Këtë e mësojmë nga një shënim i viteve 1647-1648 për një kopsht brenda kalasë, i cili zgjatej nga Jeniçeriler Kapisi deri në afërsi të kullës së tretë. Për më shumë, shih *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) Lef Nosi (32), fl. 18. Ndërsa dy portat e tjera ishin ajo e “Pazarit”, që shihte nga pjesa jugore dhe e “Ahmedajt”, e orientuar drejt Lindjes. Karaiskaj, *Pesë mijë vjet fortifikime*, 206.

<sup>13</sup> Numri i trupave ushtarake brenda kalasë ka ardhur duke u reduktuar si pasojë e vendosjes së rendit në këtë hapësirë. Kështu, ndonëse në fillim Mehmedi II këtu la 400 trupa, në regjistrin e vitit 1530 vërejmë se numri i tyre ishte 94, ndërsa në ato për vitet 1570 dhe 1583 figurojnë vetëm 69 trupa. Shih Rahman Şahin, “XVI. Yüzyılda İlbasan Şehri Sâkinleri ve Meslekleri”, *Osmanlı Medeniyeti Araştırmaları Dergisi*, sy. 22 (2024), 255.

<sup>14</sup> *Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, 719.

ndikuar edhe katastrofat natyrore. Të tilla janë rastet e tërmeteve që ranë në Elbasan, të cilat shkaktuan dëmtime në objekte të ndryshme urbanistike, përfshirë edhe muret rrethuese të kështjellës. Fjala vjen, në tërmetin e vitit 1675 mësojmë se u rrënuar kulla e kalasë që ndodhej në lagjen “Sulejmanije”, së bashku me një mesxhid që ishte aty pranë.<sup>15</sup> Një tërmet tjetër, që ra thuhet një shekull më vonë – konkretisht më 1769 – sipas burimeve, shkaktoi dëme dhe shembje në pjesë të ndryshme të xhamisë Mbret.<sup>16</sup>

Kiel shkruan se kalaja pësoi dëmtime më të shumta gjatë shek. XIX, përkatësisht si rrjedhojë e kryengritjeve kundër reformave të Tanzimatit,<sup>17</sup> një konstatim i cili është pjesërisht i drejtë, pasi dëmtimet kryesore në murin anësor të kështjellës, duke përfshirë këtu edhe portat, kishin ndodhur më herët. Kështu, në përplasjet e përgjakshme që ndodhën në qytet dhe rrethina gjatë vitit 1832, një pjesë e njerëzve të përfshirë në konflikt fshiheshin brenda mureve të kalasë, gjë e cila është bërë shkak që të shembeshin këto pjesë. Si pasojë, një pjesë e tokave pranë bedenave, sipas burimeve, iu shitën Sejfedin Beut nga paria e qytetit.<sup>18</sup>

### **Zhvillimi demografik i qytetit dhe shtimi i lagjeve**

Burimet arkivore osmane janë të sakta edhe në evidentimin e familjeve të para që u vendosën në kështjellën e rindërtuar, si edhe të vendeve nga ato kishin ardhur. Kështu, informacioni më i hershëm në lidhje me familjet e para që u sollën këtu nga osmanët, të cilët formuan edhe lagjet e qytetit-kala, gjendet në regjistrin kadastror me numër 367, që i përket vitit 1530.<sup>19</sup> Ndërsa lagjet e familjeve të deportuara, të cilat i hasim me emërtimin “xhema’at-i gebran-i syrgynan der nefsi Ilbasan”, janë këto: *mahalle-i Ohri, Kesrije, Narda, Sofja, Yskyp, Janja, Siroz, Avlonja* dhe *D(h)imo Nalband*. Ato kishin në total një numër prej 73 familjesh dhe, sipas shënimit përkatës në regjistër, ishin të përjashtuara nga taksat e ispenxhes dhe avarizit si rrjedhojë e faktit që ishin

<sup>15</sup> *Osmanlı Kaleleri*, 78.

<sup>16</sup> *Po aty*.

<sup>17</sup> Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 141.

<sup>18</sup> Për më shumë detaje, shih *Osmanlı Kaleleri*, 78.

<sup>19</sup> *Başbakanlık Osmanlı Arşivi* (BOA), TT.d. 367, fl. 432.

shpërngulur me detyrim nga vendet e tyre të mëparshme.<sup>20</sup> Sikurse mund të vërehet edhe nga emrat që mbajnë lagjet, pjesa më e madhe e këtyre familjeve vinin nga zona të banuara me popullsi shqiptare.

Krahas familjeve të deportuara, në Elbasan vërejmë edhe krijimin e lagjeve të reja me popullsi të krishterë, të cilat, sipas shënimeve në regjistër, erdhën dhe u vendosën aty me dëshirën e tyre. Bëhet fjalë për katër lagje të reja, të cilat kishin në përbërje plot 97 familje – pra, një numër më të madh se ai i popullsisë së depërtuar që u vendos me dhunë nga osmanët.<sup>21</sup> Po ashtu, edhe katër familje të tjera ishin vendosur në Elbasan gjatë kësaj kohe, të cilat kryenin shërbime të caktuara për kalanë në fjalë dhe i paguanin sanxhakbeut taksën e ispenxhes.<sup>22</sup> Brenda kalasë gjithashtu jetonin edhe 108 shtëpi myslimane.<sup>23</sup>

Si përfundim, shqyrtimi i regjistrit kadastror të vitit 1530 nxjerr në pah faktin se, vetëm gjatë dekada pas rindërtimit të kalasë, Elbasani kishte një popullsi prej thuhetse 1 500 banorësh të ndarë në 282 shtëpi, ku 174 qenë të krishtera, ndërsa 108 myslimane.<sup>24</sup>

Falë regjistrave kadastrorë të shek. XVI kemi mundësi të ndjekim zgjerimin e qytetit, si në aspektin demografik, ashtu edhe atë urbanistik, përmes krijimit të lagjeve të reja. Kështu, dy regjistra të tjerë që i

<sup>20</sup> Sipas shënimit në regjistër, këto familje të deportuara kishin qenë të detyruara të paguanin xhizjen, por përjashtoheshin nga ispenxhes dhe avariz-i divanijes. Sulltani i ri kishte urdhëruar ngarkimin e tyre edhe me taksat e lartpërmendura, por nga shqyrtimi i regjistrit të mëhershëm doli në pah fakti se ato e kishin gëzuar prej kohësh këtë privilegj të përjashtimit taksor. Prandaj, i njëjti vendim u la sërish në fuqi. Për më shumë, shih *po aty*.

<sup>21</sup> Nga leximi që i kemi bërë regjistrit kadastror të lartpërmendur, fjala është për lagjet “Selite” (?), “Istvetko” (?), “Okexhe” (?) dhe “Jorgo Niho”. *Po aty*; gjithashtu, shih Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 137.

<sup>22</sup> BOA, TT.d. 367, fl. 432. Kiel shprehet se ata kishin për detyrë të mirëmbanin urën dhe kështjellën. Shih Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 137.

<sup>23</sup> Këto ishin të ndara në këtë mënyrë: 45 shtëpi në brendësi të kalasë, 55 të tjera në hapësirën që gjendej brenda mureve rrethuese të kështjellës si dhe 8 shtëpi në atë që njihej si *mahalle-i Kosar*. Shih BOA, TT.d. 367, fl. 432. Me këtë nënkuptohet ekzistenca e një kalaje të brendshme; ajo që në termat e kohës njihej si *iç-kale*, ku përqendrohej kryesisht administrata e qytetit dhe garnizoni.

<sup>24</sup> Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 137-138. Në lidhje me rritjen demografike të Elbasanit gjatë shek. XVI dhe faktorëve që ndikuan në këtë zhvillim, shih Selami Pulaha, “Aspekte të demografisë historike të trevave shqiptare gjatë shekujve XV-XVI”, *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. I (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1989), 46-47.

përkasin të njëjtit njëqindvjeçar – përkatësisht ai i vitit 1570<sup>25</sup> dhe tjetri i vitit 1583,<sup>26</sup> na mundësojnë të evidentojmë zhvillimin e Elbasanit dhe të hapësirave urbane brenda kalasë. Në regjistrin e vitit 1570, i hartuar katër dekada pas të parit që posedojmë për këtë qytet, vërejmë një shtim të numrit të lagjeve brenda kalasë, shoqëruar natyrisht edhe me një rritje të parametrave demografikë. Më saktësisht, popullsia myslimane rezulton të jetë e organizuar në tetë lagje,<sup>27</sup> ndërsa ajo e krishterë në trembëdhjetë.<sup>28</sup>

Krahas këtyre dy grupeve të popullsisë të përmendura më sipër, në regjistrin kadastror që i përket vitit 1570 hasen edhe dy grupe të tjera. Të parët ishin ata që përmenden si *hajmanegân der neufs-i Elbasan*, të vendosur jashtë mureve të kalasë dhe, sipas të dhënave, ishin plot 88 shtëpi. Këta kanë qenë kryesisht zanatçinj, të cilët nuk ishin nën regjistrimin e një timarliu të caktuar dhe ushtronin lirshëm profesionin e tyre.<sup>29</sup> Ndërsa koptët (kıbfiler) janë shënuar në regjistër si pesë persona, të cilët ishin të angazhuar në bandën muzikore ushtarake (mehterân) dhe përjashtoheshin nga taksat e ispenxhes dhe të avarizit.<sup>30</sup>

Nga pikëpamja demografike, regjistrimi i dytë që kemi në dispozicion – ai i vitit 1570 – tregon një rritje të popullsisë së qytetit, e cila shoqërohet paralelisht edhe me numrin e lagjeve të tij. Kështu, këtë herë numri i shtëpive myslimane u rrit në 245, ndërsa ato të jomyslimanëve u reduktuan në 166, duke përfshirë këtu edhe

<sup>25</sup> BOA, TT.d. 477 i cili mban si datë përpilimi 13 Dhilhixhe 975 / 9 qershor 1568.

<sup>26</sup> *Tapu ve Kadastro Genel Müdürlüğü, Tapu Arşiv Başkanlığı, Tapu Tahrir Defterleri* (TKGM. TADB. TTD.), nr. 66, i datuar më 1 Xhemadiel’ahir 989/ 3 korrik 1581.

<sup>27</sup> Lagjja e myslimanëve brenda kalasë (xhemaat-i musulman-i dahil-i kal’a), ajo “Çavushllar”, “Hazinedaran”, “Debbaghane”, rajatë e qytetit të Elbasanit (xhemaat-i reaja-i neufs-i Elbasan), Dylgjer, Bozaxhiler, Dunxhijas. Për të dhënat mbi këto lagje, së bashku me numrin e shtëpive, shih BOA, TT.d. 477, fl. 13-14. Nga këto, katër të fundit pozicionoheshin në hapësirën jashtë kalasë.

<sup>28</sup> Të krishterët ishin organizuar në lagjet “Kesrije”, “Janja”, “Ohri”, “Avlonja”, “Yskyp”, “Sofja”, “Narda”, “Siroz”, “Okiç”, “Vaska”, “Kakruk”, “Stefo”. Për lagjet në fjalë bashkë me numrin e shtëpive, shih *po aty*, fl. 14-15.

<sup>29</sup> *Po aty*, fl. 15; Caka, “The Making of a Bordering Town”, 67; Şahin, “XVI. Yüzyılda İlbasan Şehri”, 254-255. Pulaha i përkufizon këta si “zanatçinj tregtarë të ardhur nga fshati”. Shih, Selami Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek. XV-XVI)* (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1988), 407.

<sup>30</sup> BOA, TT.d. 477, fl. 17; gjithashtu, shih Şahin, “XVI. Yüzyılda İlbasan Şehri”, 255.

*hajmaneganët*. Të gjithë këta, duke përfshirë edhe trupat mbrojtëse të qytetit dhe administratën, arrinin në një shifër prej rreth 2 300 banorësh.<sup>31</sup>

Një tablo edhe më interesante na ofron regjistri kadastror i vitit 1583, i cili është njëherazi edhe më i fundit sa i përket shek. XVI për sanxhakun e Elbasanit. Në këtë defter vërehet një trefishim i popullatës së qytetit. Sikurse do të shihet në tabelat e përmbledhura në fund të artikullit, popullsia e disa lagjeve ekzistuese të qytetit – veçanërisht atyre me popullsi myslimane – është shumëfishuar brenda një periudhe trembëdhjetëvjeçare, duke iu afruar shifrës prej 4 500 banorësh.<sup>32</sup> Këtu do të ndalemi te shkaqet që çuan në një rritje kaq domethënëse të popullatës së qytetit.

Elementi i parë që ndikoi në rritjen e popullsisë së qytetit, sipas këndvështrimit tonë, lidhej me përjashtimin taksor që përfitonin grupe të caktuara të popullsisë. Për shembull, në regjistrat e viteve 1570 dhe 1583 theksohet se banorët myslimanë të Elbasanit ishin të përjashtuar nga një kategori e caktuar taksash si rrjedhojë e angazhimit të tyre në shtypjen e rebelimeve, mbledhjen e taksave si ajo e xhizjes, dhenve etj. për llogari të padishahut, në meremetimin dhe mirëmbajtjen e xhamisë së kalasë, si edhe për marshimet nën urdhrat e bejlerëve me qëllim mbrojtjen e kalave të Bashtovës dhe të Durrësit nga armiqtë.<sup>33</sup>

Nuk ishte vetëm popullsia myslimane e qytetit ajo që përfitonte nga përjashtimi taksor në këmbim të shërbimeve të caktuara që jepnin, por edhe ajo e krishterë. Sigurisht që ekzistonte një ndarje në rastin e shërbimeve me të cilat palët angazhoheshin, për arsye se, si rrjedhojë e përkatësisë fetare, popullata e krishterë e kishte të ndaluar të përfshihej në çështje që kishin të bënin me ushtrinë apo mbledhjen e taksave, ekskluzivitet që i perkiste vetëm popullatës myslimane. Ndërsa ata të krishterë u përjashtuan nga disa zëra të taksave në këmbim të disa shërbimeve që lidheshin me mirëmbajtjen e urave, rrugëve, kullave, vëndrojave apo hambarëve dhe hapësirave të ndryshme të kalasë.<sup>34</sup>

Veçanërisht aspekti i ruajtjes dhe i garantimit të rendit dhe sigurisë kishte një rëndësi të veçantë, si për qasjen e shtetit ndaj popullatës vendëse në kuadër të lehtësimit taksor, ashtu edhe për përdorimin e saj

<sup>31</sup> Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 137-138; Şahin, “XVI. Yüzyılda İlbasan Şehri”, 254.

<sup>32</sup> Şahin, “XVI. Yüzyılda İlbasan Şehri”, 254.

<sup>33</sup> BOA, TT.d. 477, fl. 14; TKGM. TADB. TTD. 66, fl. 10b.

<sup>34</sup> Pulaha, *Pronësia feudale*, 411.

për çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes. Duke filluar nga gjysma e dytë e shek. XVI, Perandoria Osmane u angazhua në një rivalitet për dominim në hapësirat e Mesdheut Perëndimor. Për këtë qëllim, osmanëve u nevojitej fillimisht mbështetje logjistike me luftëtarë, anije, varka, rremtarë, por edhe me ushqime, të cilat siguroheshin nga resurset më të afërta që osmanët kishin me vendet nga ku do të kalonte flota e tyre. Parë nga ky këndvështrim, nevoja logjistike bëhet veçanërisht e dukshme gjatë fushatës ushtarake për rrethimin e Maltës (1565),<sup>35</sup> si edhe gjatë Luftës Osmano-Veneciane të viteve 1570-1573.

Një aspekt tjetër që ndikoi në popullimin e qytetit lidhej edhe me zhvillimin ekonomik. Me vendosjen e rendit dhe të qetësisë, Elbasani – si qendër sanxhaku, por edhe si një hambar i madh i një ekonomie të gjerë, që zinte fill nga bregdeti, duke përfshirë këtu hapësirat fushore me prodhim të bollshëm bujqësor, deri në zonat kodrinore e malore me produkte të shumta blegtorale – u shndërrua në një qendër graviteti për të gjitha resurset njerëzore dhe ekonomike të gjeografisë që e rrethonte. Ky fakt dëshmohet më së miri nga grupi i *hajmaneganëve*, për të cilët u fol më sipër, që kishin ardhur për t'u vendosur jashtë qytetit dhe ushtronin aty mjeshtërinë e tyre. Por, ky zhvillim reflektohet gjithashtu edhe me numrin e madh të esnafëve që do të vërehen në Elbasan, sidomos gjatë dekadave të fundit të shek. XVI.<sup>36</sup>

Këto rrethana janë të mjaftueshme për të kuptuar ndryshimet e mëdha që pësoi Elbasani, si në aspektin demografik, ashtu edhe në atë urbanistik, brenda një periudhe njëshekullore, duke u shndërruar në një nga qytetet më të begata të hapësirës shqiptare.

## **Fizionomia e Elbasanit në shek. XVII**

Teksa vijmë në shek. XVII, vërejmë se Elbasani ishte shndërruar tashmë në një qendër urbane dhe administrative të zhvilluar, e cila ishte bërë një destinacion i rëndësishëm për tregtarët, dijetarët dhe udhëtarët e

<sup>35</sup> Për angazhimin e shqiptarëve në përgatitjet ushtarake osmane për fushatën e Maltës, si dhe për masat e ndërmarra për mbrojtjen e brigjeve të kësaj hapësire ndaj një sulmi të mundshëm, shih Eduart Caka, “Prania e elementit shqiptar në fushatën osmane të Maltës të vitit 1565”, *Studime historike*, nr. 1-2 (2019): 42-47.

<sup>36</sup> Në lidhje me grupet esnafore në hapësirën shqiptare gjatë periudhës osmane dhe esnafët në Elbasan në veçanti, shih Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare (shek. XV-XX)* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1973).

shumtë. Lagjet kishin dalë përtej mureve të kalasë, në pjesën jugore të saj, pikërisht aty ku u pozicionua tregu i qytetit, si edhe objekte të tjera arkitekturore, si xhamitë, hamami dhe ndërtesa të tjera, të cilat mbushnin zonën midis kalasë dhe lumit Shkumbin. Kjo hapësirë territoriale emërtohet si pjesa e *Varoshit*, të cilën e hasim rëndom kur flitet për historinë e qyteteve dhe i referohet pjesës së ndërtesave dhe lagjeve që zhvilloheshin jashtë mureve të kalave. Në rastin e Elbasanit, Evlija Çelebiu – i cili e vizitoi këtë qytet në gjysmën e dytë të shek. XVII – na jep një përshkrim të detajuar të fizionomisë së tij.

Çelebiu e përshkruan pjesën e *Varoshit* si një hapësirë të zhvilluar, të mbushur me toka të punuara, vreshta e kopshte të zbukuruara, me shtëpi që kishin bahçe e shatërvanë, si dhe një numër të madh konakësh, për të cilët shprehet se ishin plot 1 150 të tillë, ku banonin paria e qytetit.<sup>37</sup> Sa i përket ndarjes së lagjeve, ai përmend 28 lagje vetëm në pjesën e *Varoshit*, nga të cilat 18 ishin të banuara nga popullsi myslimane dhe 10 të tjera nga të krishterët.<sup>38</sup> Ndonëse jep shifra të tilla, kronisti osman nuk i përmend emrat e këtyre lagjeve. Megjithatë, në lidhje me këtë çështje, janë burimet arkivore ato që na përcjellin informacione të tjera interesante mbi lagjet që kishte qyteti gjatë shek. XVII.

Në botimin e tij mbi esnafët në hapësirën shqiptare gjatë shek. XV-XIX, Zija Shkodra paraqet një listë të lagjeve të Elbasanit, të cilat, sipas referencës që përdor, duket se i ka marrë nga fondi i *Sherijes* së Elbasanit.<sup>39</sup> Të njëjtin dokumentacion duket se ka përdorur edhe politikani dhe koleksionisti Lef Nosi, i cili ka lënë pas një korpus të pasur dokumentesh e shkrimesh mbi historinë, folklorin, traditat dhe kulturën e qytetit të Elbasanit. Në fondin e lartpërmendur, Nosi prezanton një listë të lagjeve të Elbasanit, të cilat ai i ka nxjerrë nga një “protokoll vendimesh” të kadiut të Elbasanit për vitin 1013 Hixhri (1604-1605).<sup>40</sup>

Mirëpo, çfarë nënkuptohej me lagje në konceptin urbanistik osman? Në cilat rrethana mund të formohej ajo që quhej mëhallë, pra

<sup>37</sup> Ndërkohë, udhëtari osman nuk përmend lagjet brenda kalasë, por mjaftohet me pohimin se brenda saj gjendeshin gjithsej 460 shtëpi të mbuluara me çati me tjegulla. Për më shumë detaje, shih *Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, 719.

<sup>38</sup> Çelebiu shprehet gjithashtu se në qytet nuk jetonin njerëz të etnive të ndryshme, duke iu referuar hebrenjve, europianëve, armenëve, serbëve e bullgarëve, shih *po aty*, 719-720.

<sup>39</sup> Shkodra, *Esnafet shqiptare*, 46.

<sup>40</sup> *AQSH*, F. Lef Nosi (32), D. 39, fl. 65-66.

lagje? Sipas Ergenç-it, lagjja përbëhej nga një bashkësi njerëzish që njiheshin me njëri-tjetrin, kishin ndërveprime të ndërsjella dhe mbanin përgjegjësi për sjelljet e tyre.<sup>41</sup> Ndjenja e përkatësisë – qoftë fetare, etnike apo klasore – shfaqet qartë në formimin e lagjeve të Elbasanit, që prej vendosjes së familjeve të para brenda kalasë. Siç dëshmohet edhe nga emrat e lagjeve, secila prej tyre u formua nga banorë të ardhur nga vendet prej nga ishin shpërngulur. Për shembull, lagjet e Vlorës, Janinës, Shkupit, Sofjes etj.

Një tjetër ndarje që vërehet në ndërtimin e lagjeve të Elbasanit është ajo sipas përkatësisë fetare. Sikurse dallohet qartë nga shënimet e regjistrave kadastrorë, lagjet janë klasifikuar në lagje myslimane dhe të krishtera. Të njëjtën ndarje bën edhe Çelebiu kur përshkruan lagjet e qytetit. Sigurisht që një ndarje e tillë lidhej edhe me funksionimin e shoqërisë osmane brenda sistemit të mileteve, ku secili komunitet fetar kishte edhe organizimin e vet social. Këtë aspekt e vërejmë edhe në listën e lagjeve të Elbasanit që paraqet L. Nosi, ku njëra prej tyre ishte emërtuar si *Kipti Muslim*, e cila nënkupton bashkësinë myslimane të koptëve që jetonin në këtë qytet.<sup>42</sup>

Si pasojë e pozitës gjeografike, statusit administrativ si qendër sanxhaku dhe rritjes demografike, që nga gjysma e dytë e shek. XVI, në qytetin e Elbasanit vërehet një rritje e vrullshme e grupeve esnafore, të cilat do ta dominonin këtë hapësirë urbane thuajse gjatë shekujve në vijim.<sup>43</sup> Ndër to, grupi më i rëndësishëm ishte ai i artizanëve që merreshin me përpunimin e lëkurës – pra tabakët – sipas të cilëve është emërtuar edhe një nga lagjet e qytetit që në dokumente haset me emrin

<sup>41</sup> Madje, kur bëhet fjalë për qytete të homogjenizuara në aspektin fetar, përkatësisht atë të besimit islam, ai shprehet se me lagje nënkuptohej vendi ku jetonin bashkë me familjet e tyre njerëzit që luteshin në të njëjtin mesxhid. Për më shumë, shih Özer Ergenç, *Osmanlı Tarihi Yazıları: Şehir, Toplum, Devlet* (İstanbul: Tarih Vakfı Yurt Yay, 2013), 75.

<sup>42</sup> *AQSH*, F. Lef Nosi (32), D. 39, fl. 66. Një nga rrugët kryesore të qytetit ishte edhe ajo që quhej rruga e Papa Mihalit. Për më shumë, shih *po aty*, F. 32 (Lef Nosi), D. 39, fl. 68.

<sup>43</sup> Për peshën specifike që esnafët patën në jetën politike, ekonomike e kulturore të qytetit shih Shkodra, *Esnafet shqiptare*, 84, 171. Madje, grupet më të rëndësishme esnafore, si tabakët dhe terzinjtë, duket se kanë pasur edhe peshë ushtarake. Shih Eduart Caka, “Vakëfet dhe funksioni i tyre në qytetin e Elbasanit gjatë shek. XVII”, *Studime historike*, nr. 1-2 (2016): 107-108.

*Tabakhane* ose *Debbaghane*. Në këtë rast kemi të bëjmë me një ndarje të lagjeve sipas mjeshtrëve apo profesioneve të banorëve të tyre.

Një mënyrë tjetër e emërimit të lagjeve lidhet edhe me objektet e kultit që ndërtoheshin në qytet, kryesisht mesxhideve, që janë edhe xhamitë pa minare. Pjesa më e madhe e lagjeve janë të këtij formati dhe dallohen prej faktit se mbajnë emra bamirësish. Nëse xhamitë, si objekte dhe më të mëdha i shërbenin gjithë popullsisë së qytetit, mesxhidet kryesisht frekuentoheshin prej besimtarëve dhe popullatës së një rrugice të caktuar. Në veprën e tij, Çelebiu e thekson veçanërisht këtë element, duke u shprehur se Elbasani kishte njëzet mesxhide lagjesh.<sup>44</sup>

Parë në një këndvështrim më të gjerë, mesxhidet dhe objektet e tjera të kultit ishin ndërtime të sponsorizuara nga bamirës të ndryshëm dhe funksiononin në kuadër të një vakëfi të posaçëm të ngritur për këtë qëllim. Për këtë arsye, një pjesë e lagjeve ishin emërtuar edhe sipas vakëfit ose vakëflënësit që kishte ndërtuar aty veprën e bamirësisë. Fjala vjen, lagjja “Gjeda” e kishte marrë emrin nga vakëfi me të njëjtin emër, të cilën L. Nosi e ka shënuar si “Baba Gjeda Vakf Mehallesi”.<sup>45</sup> Kjo lagje ndodhej brenda kalasë. E njëjta gjë vlen edhe për lagjet “Kujum Bej” dhe “Qejvanije” që i kishin marrë emrat respektivisht nga vakëfet e Kujum Beut dhe Kejvan ose Qejvan Beut.<sup>46</sup>

Lagjet e qytetit kryesisht ishin të vogla dhe përbëheshin nga disa familje, një pjesë e të cilave kishin lidhje gjaku, që jetonin në një hapësirë të kufizuar dhe ndaheshin nga njëra-tjetra me rrugicat e qytetit. Për më tepër, ky aspekt del qartë në pah edhe nga emërtimet e rrugicave të këtyre lagjeve, ku në disa raste rrugicat mbanin të njëjtin emër me lagjet përkatëse. Fjala vjen, lagjet “Davut Bej” apo “Kipti Muslim” mbartnin të njëjtin emërtim që kishin edhe rrugicat e tyre.<sup>47</sup>

Në rastin e Elbasanit, burimet arkivore, veçanërisht fondi i Lef Nosit, i cili ishte vetë nga ky qytet dhe e njëjta nga afër toponiminë e tij, na ndihmojnë të përcaktojmë edhe rrugët kryesore të qytetit për periudhën që po shqyrtojmë. Ajo që bie menjëherë në sy është fakti se ato janë emërtuar sipas objekteve kryesore të jetës fetare, ekonomike apo sociale të qytetit. Për shembull, disa prej rrugëve janë: Rruga e Xhamisë Mbret,

<sup>44</sup> *Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, 721.

<sup>45</sup> *AQSH*, F. Lef Nosi (32), D. 39, fl. 65.

<sup>46</sup> *Po aty*, fl. 66.

<sup>47</sup> *Po aty*.

Rruga e Topit, Rruga e Hamamit, Rruga e Medresesë.<sup>48</sup> Këto rrugë kryesore, të cilat fillonin ose përfundonin pranë objekteve më të rëndësishme arkitekturore të qytetit, përbënin edhe arteriet kryesore nga të cilat degëzoheshin edhe rrugicat dytësore që depërtonin në brendësi të lagjeve.

Panorama bëhet edhe më e qartë kur flitet për rrugicat e tregut. Kjo, pasi në praktikën osmane të funksionimit të esnafëve, këto grupe duhej ta ushtronin aktivitetin e tyre në mënyrë të organizuar. Pra, secila kategori e artizanëve i kishte punishtet dhe dyqanet e veta të organizuara në mënyrë të përbashkët dhe të ndara nga ato të mjeshtërive të tjera. Nisur nga ky parim, grupet që zotëronin mjeshtëritë më të lëvruara dhe që kishin dyqanet e tyre në pazarin e qytetit, kishin gjithashtu edhe rrugicat përkatëse që mbanin emrat e zanateve të tyre, siç ishin: “‘rruga e ‘briskaxhinjve’, ‘kujumxhinjve’, ‘pasmxhinjve’, ‘drithnave’, ‘leshnave’, ‘kasapëve’, ‘samarxhinjve’, ‘tabakëve’, ‘saxhamxhinjve’ etj”.<sup>49</sup>

Sigurisht që dyqanet ishin të përfshira edhe në pjesën tjetër të lagjeve, pra jo vetëm aty ku pozicionohej pazari. Për shembull, nga një dokument i viteve 1638-39, mësojmë se dyqanet e simitçinjve dhe ekmeçinjve – pra, atyre që piqnin simite e bukë – ndodheshin në lagjen “Kalender” të qytetit.<sup>50</sup> Sikurse shprehet edhe Çelebiu, Elbasani nuk kishte një bezestan në formën e mirëfilltë të një ndërtese, të fortifikuar, që hapej ditën dhe mbyllej në mbrëmje, ku tregtoheshin mallrat e shtrenjta. Megjithatë, ai shkruan se këtu mund të gjendej gjithçka që tregtohej në një bezestan.<sup>51</sup> Pra, vlen të theksohet se, ndonëse nuk ekzistonte një bezestan i mirëfilltë sikurse vërehej në qytetet e tjera të perandorisë, në aspektin funksional dhe toponimik, bezestani ishte i pranishëm në përditshmërinë e tregtarëve dhe banorëve të Elbasanit.

Me zhvillimin e qytetit në aspektin demografik dhe urbanistik vërehet edhe një shtim i numrit të lagjeve, veçanërisht në fundin e shek. XVII dhe fillimet e shek. XVIII, ndryshime të cilat sollën dinamika të

<sup>48</sup> *Po aty*, fl. 68.

<sup>49</sup> Në listën e dhënë nga L. Nosi përfshihen edhe rrugicat e Qoshes, Ndër-enët, Gjirokastrës dhe Maxharit, të cilat nuk kanë emërtim sipas mjeshtërive, ndaj edhe po i shtojmë këtu. Për më shumë, shih *Po aty*.

<sup>50</sup> *Po aty*.

<sup>51</sup> Kronisti osman shprehet se pazari i Elbasanit kishte plot 900 dyqane dhe shquhej veçanërisht për përpunimin e mëndafshit dhe prodhimin e thikave, shpatave e harqeve. Për më shumë, shih *Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, f. 721-722.

tjera në funksionimin e jetës ekonomike, kulturore e sociale të qytetit. Vijimësia e këtyre lagjeve, së bashku me emërtimet e tyre përkatëse, u ruajt deri në dekadat e para të shek. XX, kur ato iu nënshtruan një ristrukturimi të ndërmarrë nga komanda austriake, me synimin për t'u menaxhuar më lehtësisht (shih tabelën 4).<sup>52</sup> Ky grupim, i bazuar në afërsinë gjeografike të lagjeve, na ndihmon të përfytyrojmë edhe peizazhin urbanistik të qytetit të Elbasanit gjatë periudhës osmane.

### Objekte dhe mjedise të transformimit urban

Nëse siluetën e qytetit të Elbasanit e formonin muret e mëdha të kalave dhe objektet e kultit të ngritura gjatë periudhës së sundimit osman, siç e pamë edhe më lart, në brendësi të tij qyteti paraqiste një larmi të madhe me objekte arkitekturore, lagje e rrugica që u shtuan paralelisht me zhvillimin ekonomik e kulturor të kësaj qendre urbane, si edhe me rritjen demografike që ajo pësoi në kohë. Formësimi i këtij peizazhi urbanistik duket se ka ndodhur kryesisht në gjysmën e dytë të shek. XV dhe ka vijuar gjatë gjithë shekullit pasues. Kështu, në dekadat e para të shek. XVII, Elbasani na shfaqet tashmë si një qytet i zhvilluar për kohën, veçanërisht në krahasim me qytetet e tjera të hapësirës shqiptare. Këtë element e thekson edhe Çelebiu, i cili e cilëson atë si “nusen e Rumelisë”<sup>53</sup> për bukurinë dhe zhvillimin që kishte arritur kjo qendër.

Gjatë shek. XVII, Elbasanit iu shtuan edhe objekte dhe ambiente që pasuruan mjedisin urban, por edhe shërbyen si hapësira në funksion të nevojave të banorëve. Kështu, objekti më i rëndësishëm që iu shtua qytetit, duke ndryshuar edhe pamjen e tij gjatë kësaj kohe, ishte kulla e sahatit. Çelebiu e përshkruan këtë objekt me hollësi, duke theksuar se ajo ishte ndërtuar në mënyrë mjeshtërore dhe kishte një saktësi të lartë në matjen e kohës, aq sa edhe myezinët e qytetit i referoheshin asaj në thirrjen e ezanit.<sup>54</sup>

Nisur nga fakti se Elbasani ishte një qytet me resurse të mëdha ujore përreth, banorët e tij e kanë përdorur këtë element jetik si për nevojat konsumatore, ashtu edhe për ujitje. Ndërsa në fillimet e shek. XVII, vërejmë se është shfrytëzuar jo vetëm për përmbushjen e këtyre

<sup>52</sup> AQSH, F. Lef Nosi (32), D. 39, fl. 67.

<sup>53</sup> Caka, “Vakëfet dhe funksioni i tyre në qytetin e Elbasanit”, 109.

<sup>54</sup> *Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, 722. Për historinë e kullës së sahatit në shekujt e mëvonshëm, shih Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri*, 162.

nevojave, por edhe si element zbukurues që pasuronte peizazhin e qytetit. Kështu, krahas tri hamameve ekzistuese, të cilat shërbenin si për higjienë, ashtu edhe si mjedise socializimi, mësojmë se në fillimet e këtij njëqindvjeçari, konkretisht në vitin 1616 në qytet janë ndërtuar edhe çezma publike. Lef Nosi,<sup>55</sup> i cili na jep këtë informacion, nuk e përmend numrin e saktë të çezmave apo bamirësit që sponsorizuan ndërtimin e tyre, por përdorimi i numrit shumë në përshkrimin e këtyre objekteve tregon për praninë e më shumë se një objekti të tillë.

Një tjetër risi sociale për kohën – nëse marrim parasysh përhapjen e saj fillimisht në Perandorinë Osmane dhe më pas edhe në Europë – ishte kultura e kafesë dhe e kafeneve.<sup>56</sup> Studimet tregojnë se kafenetë e para në Stamboll u shfaqën që në gjysmën e parë të shek. XVI, për t’u përhapur më vonë edhe në pjesët e tjera të Perandorisë Osmane. Ato frekuentoheshin kryesisht nga elitat kulturore e politike të qyteteve, duke u shndërruar në mjedise ku shpeshherë lindnin thashetheme, kritika dhe rebelime ndaj pushtetit, gjë e cila bëri që sulltanë të ndryshëm të nxirrnin fermane të posaçme me anë të të cilave ndalonin aktivitetin e kafeneve.<sup>57</sup>

Edhe në rastin e Elbasanit, ndonëse mbetet e panjohur data e saktë e hapjes së kafeneve të para në qytet, Çelebiu evidenton plot shtatë të tilla aty rreth vitit 1670. Sipas kronistit osman, këto ambiente – të cilat frekuentoheshin nga elitat politike, ekonomike e kulturore të qytetit – ndodheshin të pozicionuara ndërmjet portës kryesore dhe çarshisë që ndodhej aty pranë,<sup>58</sup> pjesë e cila përkon me zonën ku sot gjendet bulevardi i qytetit.

## Përfundim

Ripopullimi i Elbasanit nga Mehmedi II në vitin 1466, si edhe kthimi i tij më vonë në një qendër sanxhaku, ndikuan ndjeshëm në rritjen ekonomike, demografike e kulturore të këtij mjedisi urban. Në këtë

<sup>55</sup> AQSH, F. Lef Nosi (32), D. 39, fl. 93. Ndërsa shatërvani i ndërtuar në mes të pazarit, i cili ka ekzistuar deri në shek. XX, sipas shënimeve në të njëjtën fletë, rezulton të jetë ndërtuar në vitin 1743.


<sup>56</sup> Në lidhje me kulturën e kafesë në Perandorinë Osmane, shih İdris Bostan, “Kahve”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXIV (İstanbul: TDV Yay., 2001), 202-205; Ahmet Yaşar, “Kahvehane”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. Ek-2 (Ankara: TDV Yay., 2019), 3-5.

<sup>57</sup> Yaşar, “Kahvehane”, 3.

<sup>58</sup> *Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, 722.

artikull u përpoqëm të ndjekim linjën zhvillimore të qytetit përgjatë dy shekujve të parë nën sundimin osman përmes transformimeve urbanistike që pësoi vetë Elbasani, duke analizuar mënyrën e formimit të lagjeve dhe të elementeve që karakterizonin banorët që jetonin në to. Vetë pozita gjeografike e qytetit si pikë lidhëse ndërmjet bregdetit dhe brendatokës – që shtrihej deri në thellësi të Ballkanit – funksioni i tij si qendër administrative, resurset natyrore dhe ekonomike, si dhe fakti që ishte një hapësirë kufitare, ishin faktorë që ndikuan drejtpërdrejt në zhvillimin shumëdimensional të këtij qyteti.

*Planimetri e kalasë së Elbasanit në shek. XIX<sup>59</sup>*



<sup>59</sup> *Osmanlı kaleleri*, 79.

Tabela 1: *Lagjet e Elbasanit sipas regjistrave osmanë të shek. XVI*

<b>TT.d 367, viti 1530*</b>	<b>TT.d 477, viti 1570**</b>	<b>TTD 66, viti 1583***</b>
1. Nefs-i kala	Dahil-i kala	Dahil'i kala
2. Birun-i kala	Çaushlar	Çaushlar
3. Kosar	Hazinedaran	Hazinedaran
4.	Debbaghane	Debbaghane
5.	Reaja-i nefsi Ilbasan	Reaja-i nefsi Ilbasan
6.	Dylgjer	Dylgjer
7.	Bozaxhijas	Bozaxhijas
8.	Dubxhijas	Dubxhijas
9. Ohri	Ohri	Ohri
10. Kostur	Kostur	Kostur
11. Narda	Narda	Narda
12. Sofje	Sofje	Sofje
13. Shkup	Shkup	Shkup
14. Janinë	Janinë	Janinë
15. Serez	Serez	Serez
16. Vlora	Vlora	Vlora
17. Dhimo Nallband	Okiç	Okiç
18. Belene	Gorixhe (Gjurica?)	Gorice (Gjurica)
19. Okiç	Vaska	Vaska
20. Cvetko	Isteko (Stefo?)	Isteko (Stefo?)
21. Jorgo Niho	Kakruk	Kakruk

Tabela 2: *Lagjet e Elbasanit në shek. XVII*

<b>Lagjet e Elbasanit sipas Z. Shkodrës</b>	<b>Lagjet e Elbasanit sipas L. Nosit</b>
1. Çeribashi	Aga Mahallesi në kala
2. Çaushli	Ali Çaush

\* Tri lagjet e para banoreshin nga popullsi myslimane, ndërsa lagjet e tjera – nga ajo e Ohrit deri te lagja “Dhimo Nallband” – përbëheshin nga familje që u shpërngulën me detyrim nga Mehmedi II dhe u vendosën në Elbasan. Katër lagjet e fundit ishin të banuara nga të krishterë që erdhën dhe u vendosën në qytet.

\*\* Tetë lagjet e para ishin të banuara nga myslimanët, ku ato të Reaja-i nefsi Ilbasan, Dylgjer, Bozaxhijas dhe Dubxhijas ishin lagje të reja që u ngritën jashtë mureve të kalasë. Ndërsa lagjet e tjera, edhe pse me numër më të vogël familjesh, ishin të banuara nga popullsi e krishterë.

\*\*\* Lagjet e Elbasanit, që përmenden në regjistrin e vitit 1570, kanë vijuar të ekzistojnë edhe në regjistrimin tjetër të mbajtur 13 vjet më vonë. Ndryshimi i vetëm ka të bëjë me rritjen demografike që kanë pësuar këto lagje.

3. Kazan Bej	Arsllan Çaus
4. Hurdhe	Balli Bej
5. Xhami Qebir	Bashçi Mustafa
6. Haxhi Zade	Binak
7. Spahi (Spahikore)	Bujuk Xhami në kala
8. Gjeda	Çaushtiler
9. Haxhi Iljas (Haxhijas)	Çeribashi
10. Xhami Sherif	Davut Bej
11. Gjevan Bej	Debbaghane
12. Hasinedar	Enbar në kala
13. Sinan Aga	Esqi Hamam në kala
14. Iskender Bej	Gjeda në kala
15. Dervish Bej	Hasan Balli
16. Tabakhane	Haxhi Brenesh
17. Haxhi Sulejman	Haxhi Eljaz
18. Zaranikë	Haxhi Hasan
19. Haxhi Hysen	Haxhi Sulejman
20. Sinan Balli	Haxhi Zadeler
21. Lagjja e Re	Haxhi Zelka
22. Lagjja e Jevgjëve	Hazinedarli
23. Memi Nazar	Hurdha
24. Soufiler	Isgender Hoxha
25. Mahmud Aga	Kalender
26. Xhevari	Karabinarlli
27. Kala	Karaveli
28. Zeraat	Kapuxhibashlli****
29.	Kujum Bej
30.	Koçi Bej
31.	Kova Spahi
32.	Kusarth*****
33.	Memi Nazir
34.	Nazir Ogllu (Nazirzade)
35.	Pervin Aga
36.	Qejvan Bej
37.	Seraç Memi
38.	Serflok
39.	Sinan Aga

\*\*\*\* Për këtë lagje shkruan se ndodhej në Gjergjan.

\*\*\*\*\* Varet nga Elbasani.

40.	Trak
41.	Xhami-i Qebir
42.	Xhami-i Sherif
43.	Xhuri
44.	Zeraniq

Tabela 3: *Lagjet e Elbasanit në fundin e sundimit osman dhe rigrupimi i tyre prej austro-hungarezëve në lagje të reja*

<b>Lagjet e Elbasanit në periudhën e vonë të sundimit osman</b>	<b>Lagjet e Elbasanit të rigrupuara prej komandës austriake</b>
1. Alauddin (Lejdine)	Allauddine (1. Alaudidin, 2. Bodur Isqender, 3. Baba Ogllu)
2. Asllan Bej	Asllanbeje (1. Arslan Bej, 2. Esqi Çeribash, 3. Çaushli)
3. Baba Gjeda	Dautbeje (1. Duat Bej, 2. Karabinjar, 3. Xhyrja, 4. Kipti Myslim)
4. Baba Ogllu	Deruni Kala (1. Deruni Kala, 2. Haxhias, 3. Niçare, 4. Kukunja)
5. Benjli Hasan	Dylgjerhysejne (1. Dylgjer Hysein, 2. Myzyr Hysejin)
6. Bodur Isqender	Hazinedare (1. Hazinedare, 2. Ebu Beqir Çelepi)
7. Çaushli	Karavelie (1. Kara Veli, 2. Bejnli Hasan)
8. Daut Bej	Pervinagaje (1. Pervin Aga, 2. Kalenderie, 3. Sabuni)
9. Deruni Kala	Qejvanbeje (1. Qejvan Bej, 2. Baba Gjeda)
10. Dylgjer Hysein	Spahikorre (1. Spahi Korra)
11. Ebu Beqir Çelepi	Sulejmanie (1. Sulejmanie, 3. Haxhi Hasan)
12. Esqi Çeribash	Shinkolla (1. Shinkolla)
13. Hamami Atik	Xhamiqebire (1. Xhami-i Qebir, 2. Silahshore, 3. Sofiune, 4. Kulle, 5. Hamami Atik)
14. Haxhias	
15. Haxhi Hasan	
16. Hazinedar	
17. Spahi Korra	

18. Kalenderie	
19. Kara Veli	
20. Kipti Myslim	
21. Kukunja	
22. Kule	
23. Karabinjar	
24. Myzyr Hysein	
25. Niçare	
26. Pervin Aga	
27. Qejvan Bej	
28. Sabuni	
29. Sulejmanie	
30. Shinkolla	
31. Silahshor	
32. Sofiune	
33. Xhamiiqebir	
34. Xhyra	

### **Burime e bibliografi:**

#### **Arkiva:**

*Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)*

- Fondi Lef Nosi (32).

*Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Osmanlı Arşivi (BOA), TT.d. 367, 447.*

*Tapu ve Kadastro Genel Müdürlüğü, Tapu Arşiv Daire Başkanlığı, Tapu*

*Tahrir Defterleri (TKGM. TADB. TTD.), nr. 66.*

#### **Botime dokumentare:**

*Arşiv Belgelerine Göre Osmanlı Kaleleri.* İstanbul: Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, Osmanlı Arşivi Daire Başkanlığı, 2016.

*Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë (shek. X-XV).* Përgatiti Koço Bozhori, Filip Liço. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1975.

*Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV (Burime osmane)*. Përgatiti për shtyp Selami Pulaha. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1968.

### Literaturë historiografike:

BABINGER, Franz. *Aufsätze und Abhandlungen zur Geschichte Südosteuropas und der Levante*, v. I. München: Schmidt & Klaunig Kiel, 1962.

BOSTAN, İdris. “Kahve”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXIV. İstanbul: TDV Yay., 2001.

BUHARAJA, Vexhi. “Rreth mbishkrimeve të fortesës së Elbasanit”. *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. II. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1989.

CAKA, Eduart. “Prania e elementit shqiptar në fushatën osmane të Maltës të vitit 1565”. *Studime historike*, nr. 1-2 (2019): 35-54.

CAKA, Eduart. “The Making of a Bordering Town: The City of Elbasan during XV-XVI Centuries”. *Albanian Studies*, no. 2 (2023).

CAKA, Eduart. “Vakëfet dhe funksioni i tyre në qytetin e Elbasanit gjatë shek. XVII”. *Studime historike*, nr. 1-2 (2016): 99-114.

EGRO, Dritan. “Islam in Albanian Lands during the First Two Centuries of the Ottoman Rule”. *Ph.D Dissertation*. Ankara: University of Bilkent, 2003.

ERDEM, Sargon. “Ayak”. *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. IV. İstanbul: TDV Yay, 1991.

ERGENÇ, Özer. *Osmanlı Tarihi Yazıları: Şehir, Toplum, Devlet*. İstanbul: Tarih Vakfı Yurt Yay, 2013.

*Evlilya Çelebi Seyahatnamesi*, C. 8. İstanbul: Orhaniye Matbbası, 1928.

*Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Illirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet ’20 të shek. XIX). Redaktor shkencor Kristaq Prifti, grup autorësh. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002.

KARAIKKAJ, Gjerak. *Pesë mijë vjet fortifikime në Shqipëri*. Tiranë: 8 Nëntori, 1980.

KIEL, Machiel. *Arkitektura osmane në Shqipëri (1385-1912)*. Përktheu Klodiana Smalajaj. Tiranë: AIITC, 2012.

- KIEL, Machiel. "İlbasan". *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXII. İstanbul: TDV Yay., 2000.
- LJUBIĆ, Sime. "İzvještaj god. 1570 o Arbanaskoj". *Starine*, XII. Zagreb: Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti 1880.
- PULAHA, Selami. "Aspekte të demografisë historike të trevave shqiptare gjatë shekujve XV-XVI". *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. I. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1989.
- PULAHA, Selami. *Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek. XV-XVI)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1988.
- ŞAHİN, Rahman. "XVI. Yüzyılda İlbasan Şehri Sâkinleri ve Meslekleri". *Osmanlı Medeniyeti Araştırmaları Dergisi*, sy. 22 (2024).
- SHKODRA, Zija. *Esnafet shqiptare (shek. XV-XX)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1973.
- TODOROV, Nikolai. *The Balkan City, 1400-1900*. Seattle: University of Washington Press, 1983.
- YAŞAR, Ahmet. "Kahvehane". *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. Ek-2. Ankara: TDV Yay., 2019.
- WATENPAUGH, Heghnar Zeitlian. *The Image of an Ottoman City: Imperial Architecture and Urban Experience in Aleppo in the 16<sup>th</sup> and 17<sup>th</sup> Centuries*. Leiden: Brill, 2004.

**DR. EDUART ÇAKA**

Institute of History / Academy of Sciences of Albania  
edicaka@hotmail.com

*S u m m a r y*

PHYSIOGNOMY OF A CITY: URBAN SPACE AND NEIGHBORHOODS OF  
ELBASAN DURING THE 16TH-17TH CENTURIES

In this article we aim to present the development panorama that the city of Elbasan underwent during the 16th-17th centuries, focusing on two main parameters, demographic and infrastructural, with the aim of thus realizing an urban vision of one of the largest Albanian cities of the Ottoman era. More specifically, the article consists of addressing the factors

that influenced the economic, demographic, cultural and political growth of this important demographic center, focusing especially on the urban expansion that it underwent from the re-foundation of the castle, the emergence of neighborhoods through the surrounding walls and other elements that influenced the shaping of the urban landscape for a period of almost two centuries.

**Key words:** Elbasan, Ottoman period, Architecture, Urban space, Neighborhoods.